# Si të hapni një llogari në Interactive Brokers

Interactive Brokers (IBKR) është një platformë ndërkombëtare brokerimi me bazë në Amerikë, e themeluar në vitin 1978 nga Thomas Peterffy. Kompania ofron një platformë elektronike të tregtimit për një gamë të gjerë produktesh financiare, duke përfshirë aksione, opsione, kontrata futures, obligacione, fonde të ndërsjella, valuta, kriptovaluta dhe kontrata për diferencë (CFD). Kjo platformë operon në 34 vende dhe mbështetë 27 monedha. Interactive Brokers shërben për investitorë individual dhe për institucione financiare.

Në vijim do ta keni një udhëzues hap pas hapi se si të hapni një llogari në Interactive Brokers.

Të dhënat që ju duhen për të hapur llogari janë:

1. Informatat personale
2. Verifikimi i identitetit
3. Dëshmi e vendbanimit
4. Informata rreth financave tuaja
5. Informata rreth eksperiencës në investime

Vizitoni faqën Home | Interactive Brokers LLC dhe klikoni në butonin lart djathtas "Open account":




Hapi i radhës është të klikoni “Start application” dhe këtu fillon plotësimi i të dhënave tuaja për të hapur llogarinë:




Në hapin e rradhës ju duhet të shkruani e-mailen tuaj, të zgjidhni një “username” të lirë dhe të vendosni fjalëkalimin. Poashtu, këtu zgjedhni shtetin ku për momentin jeni rezident.




Vazhdoni me konfirmimin e e-mailes tuaj:







Si dhe përzgjedhjen e llojit të llogarisë:




Dallimi mes llogarive:

1. Individual - llogari që mund ta përdorni ju si individ
2. Joint - llogari që mund të kenë qasje edhe partneri/ja juaj
3. Retirment account - llogari të pensionit të cilat janë të qasshme vetëm nga shtetasit Amerikan

Për shembullin tonë do të përdorim llogarinë individuale.

## Informatat personale

Salutation | First Name | Middle Name(s)

C | Required |

Last Name

Required

Address Line One

Building Number and Street Name

Address Line Two

Apt, Suite, Floor, etc.

City | State/Province | Zip/Postal Code

Required | | Required

☐ I have a different mailing address.

☐ I have a different citizenship other than Kosovo.

☐ I was born outside of Kosovo.

Phone Type | Location | Phone Number

Mobile | Kosovo | Required

+ Add Phone Number




Tax Identification Number - Ky është numër fiskal, të cilin mund ta merrni në Administraten Tatimore të Kosovës.



Për t'u regjistruar në platformën Interactive Brokers, ju duhet njëra nga këto dokumente:

1. Lejeqëndrimi
2. Leja e makinës
3. Letërnjoftimi apo
4. Pasaporta







My Employment

Full Employer Name

Required

Country

Kosovo

Address Line One

Building Number and Street Name

Address Line Two

Apt, Suite, Floor, etc.

City

Required

State/Province

Zip/Postal Code

Required

Nature of Business

Choose One

Occupation

Tek burimi i të hyrave, mund të përzgjedhni njërën nga:

1. Të hyrat e partnerit
2. Ndihmat sociale
3. Të hyrat nga punësimi
4. Trashëgimia
5. Dividenta
6. Të hyrat nga tregtimi i tregut financiar
7. Pensioni
8. Pronat
9. Të tjera




Valuta bazë - Valuta në të cilën dëshironi të figuroj vlera e portfolios tuaj, dhe valuta në të cilën dëshironi të bëni depozita / tërheqje.




Në këtë pjesë duhet të përgjigjeni në tri pyetje që i përzgjidhni ju, të cilat do të shërbejnë si pyetje sigurie në rast që humbisni fjalëkalimin ose keni probleme tjera teknike të kyqjes në platformë.




Janë gjithësej 3 lloje të ndryshme të llogarive që mund t'i hapni në Interactive Brokers:

1. Cash – Mund të tregtoni vetëm me mjetet tuaja që i depononi
2. Margin – Në këtë lloj të llogarisë brokeri ju mundëson të tregtoni me shumën 4 herë më të madhe se ato që keni deponuar. KUJDES: Në shumën e huazuar ju do të paguani interes për aq sa i shfrytëzoni
3. Portfolio Margin – Një lloj tjetër i llogarisë ku mund të shfrytzoni para të huazuara në një kalkulim më kompleks dhe ku ju duhen dikun mbi $100,000 për të pas qasje në këtë lloj llogarie.

Në këtë pjesë poashtu duhet të përzgjedhni informata rreth pasurisë tuaj dhe të hyrave vjetore.







Tek objektivat e investimit, ju duhet të përzgjedhni se a dëshironi:

1. Të mbroni kapitalin egzistues dhe të gjeneroni të hyra
2. Të bëni rritjen e kapitalit
3. Të bëni tregtim të dy anshëm (si në ngritje të vlerës ashtu dhe në rënje të vlerës së aseteve të tregtueshme)
4. Të bëni tregtim aktiv dhe të përdit’shëm

Në kolonën e dytë të tabelës së objektivave të investimit, e keni rrezikun që bartin këto përzgjedhje. Përzgjedhja e objektivave vetëm e njofton

platformën interactive brokers me tolerancën tuaj ndaj riskut dhe nuk ndikon në portfolion tuaj. Sidoqoftë, kjo mund të ndikoj në qasjen tuaj në llojet e ndryshme të llogarive (nëse përzgjedhni risk të ulët, nuk mund të përdorni huazime nga brokeri).




Tek eksperienca e tregtimit dhe produktet, keni mundësinë të përzgjedhni se cilat lloje të aseteve dëshironi t’i tregtoni. Përveç 4 produkteve që janë të listuara në tabelën më poshtë, nëse klikoni “Additional Products”, mund të shtoni edhe 5 lloje tjera të produkteve shtesë.


Trading Experience and Permissions
Your choices below determine the investment products that can be approved to trade. Add all that apply.
Additional Products
Choose One
Stocks
Select Experienc
Select Trades pe
Select Knowledg
Permissions to Trade:
Global (Trade in Fractions)
United States
Add
Options
Permissions to Trade:
Add
Forecast and Event Contracts
Permissions to Trade:
Add
Currency/Forex
Permissions to Trade: Currency Conversion


Additional Products
Choose One
Choose One
Bonds
Futures
Futures Options
Mutual Funds
Complex or Leveraged Exchange Traded Products
Stocks
Select Experienc
Permissions to Trade:

Si hap i fundit për të finalizuar aplikimin tuaj për hapje të llogarisë në Interactive Brokers, ju duhet të firmosni (shënoni emrin mbiemrin tuaj) dhe të siguroni se të dhënat e ofruara përgjatë aplikimit janë të sakta. Në hapin e rradhës pasi të klikoni “Continue”, ju do të njoftoheni nëse keni bërë ndonjë gabim gjatë aplikimit dhe do të ju kërkohet të përmirsoni atë, ose në të kundërtën do të njoftoheni që aplikimi ka përfunduar me sukses.

Interactive Brokers pastaj do të ju njoftoj brenda 2-3 ditëve pune me statusin e aplikimit juaj për hapjen e llogarisë.




Pasi të keni hapur llogarin, ju duhet prap të vizitoni faqën e brokerit dhe të klikoni tek “Log In”, pastaj “Portal Login”.




Në këtë faqe ju duhet të shënoni emrin e përdoruesit që keni përzgjedhur si dhe fjalëkalimin tuaj. Tek pjesa djathtas lart është mundësia të qaseni në llogarinë “Live” ose “Paper”. “Paper” është një lloj i llogarisë me mjete imagjinare, me të cilat mund të tregtoni dhe të testoni strategji të ndryshme, pa rrezikuar mjetet tuaja reale.



Në rast që jeni qasur tek llogaria juaj reale, në pjesën majtas (të hijezuar me të kuqe) mund të klikoni për të vizituar faqën ku do të depononi mjete nga llogaria juaj bankare.




Përzgjedhni valutën që dëshironi të përdorni (valuta e përzgjedhur këtu duhet të përshtatet me valutën që e përdorni në llogarinë tuaj bankare). Duke klikuar “Get instructions” tek pjesa “Bank Wire”, do të vizitoni faqen ku i keni udhëzimet se si ti dërgoni parat në llogarinë bankare të Interactive Brokers.




Pasi t’i shënoni të dhënat tuaja, brokeri juaj do të krijoj një “urdhër të hapur” për pranimin e shumës që keni caktuar nga llogaria që keni caktuar. Ky urdhër pagese do të jetë aktiv përderisa ju i depononi mjetet që keni cekur në këtë faqe. Posa të pranohen mjetet tuaja, ato do të

figurojnë në llogarinë e Interactive Brokers dhe ju mund t'i investoni apo të tregtoni me to.

